



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA / KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

NJËSIA PËR INSPEKTIM GJYQËSOR / JEDINICA ZA SUDSKU
INSPEKCIJU /JUDICIAL INSPECTION UNIT

R A P O R T

INSPEKTIMI – RASTET PENALE “KOBRA”

Janar 2023

HYRJE

Me datë 5 janar 2023, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës z. Albert Zogaj, pas shqetësimeve të ngritura lidhur me rastin e vrasjes në Prizren, veçanërisht lidhur me njërin prej të pandehurve të quajtur Dibran Hoxhaj i njohur si “Kobra”, dhe për të cilin në opinion pretendohet se kishte numër të madh të veprave penale të kryera, nga Njësia për Inspektim Gjyqësor, me shkrim ka kërkuar që lidhur me çështjen e ngritur në opinion, të veprojë menjëherë brenda përgjegjësisë ligjore¹ të cilat i ka, dhe pos tjerash, lidhur me rastin të ndërmerr këto veprime:

- Të sigurohen të dhëna nga Sistemi Qëndror i Evidencës Penale dhe Sistemi “SMIL”;
- Të sigurohen të dhëna për rastet penale për Dibran Hoxhaj në secilën gjykatë;
- Të sigurohen vendimet dhe informacion për ekzekutimin e vendimeve në secilën gjykatë;
- Të sigurohet informacion për dosjet eventuale të papërfunduara dhe kohëzgjatja e secilës dosje në gjykatata, përfshirë edhe rastet e përfunduara dhe informacionin lidhur me pretendimin, nëse janë zhdukur prova të cilat kanë qenë duke u ruajtur në gjykatë.

Veprimet e Njesisë:

1. Ndërtimi ekipor në përbërje prej: Flora Balidemaj-Hoxha, Inspektore e Lartë Gjyqësore dhe Tevide Limoni-Konjuvca, Inspektore e Lartë Gjyqësore.

Kërkesat e adresuara:

1. Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren;
2. Administratores së Gjykatës Themelore në Prizren;
3. Administratorit të Gjykatës Themelore në Ferizaj;
4. Zyrës për evidencë penale në SKGJK;
5. Drejtorit të Departamentit të TI-së, në SKGJK.

Metedologjia e përdorur:

1. Krahasimi i të dhënave të ofruara nga Zyra për evidencë penale në SKGJK për numrin e lëndëve penale në të cilat ka qenë i pandehur Dibran Hoxhaj;
2. Inspektimi i 23 lëndëve ku i pandehur ka qenë Dibran Hoxhaj.

¹ Rregullorja nr.14/2022 Neni 4 Kompetencat dhe përgjegjësitë e Njesisë, par. 1 pika 1.5; me kërkesën e Këshillit, kryesuesit, komisioneve, paneleve dhe trupave tjerë të themeluar nga Këshilli, ofron mbështetje profesionale dhe administrative, lidhur me çështje që kanë të bëjnë me vlerësimin e performancës dhe procedurave disiplinore për gjyqtarë dhe të punësuarve tjerë Brenda sistemit gjyqësor në përputhje me ligjet e aplikueshme dhe aktet e miratuara nga Këshilli.

Të gjeturat:

- **Sipas pikës 1** të kërkesës së Kryesuesit të KGJK-së, Njësia për Inspektim Gjyqësor (më tutje Njësia), ka kërkuar të dhëna nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale dhe ka pranuar Listën, në të cilën figuron se, i pandehuri Dibran Hoxha ka pasur 18 lëndë penale gjithsej, nga të cilat 17 lëndë në Gjykatën Themelore në Prizren dhe 1 lëndë në Gjykatën Themelore në Ferizaj. Sipas kësaj liste del se, i pandehuri Dibran Hoxhaj nuk ka lëndë në Gjykatat tjera, (aktgjykime të plotfuqishme, ku të pandehurit i janë shqiptuar dënime).

Nga kërkimet e bëra në sistemin SMIL del se, i pandehuri Dritan Hoxha ka lëndë penale vetëm në Gjykatën Themelore në Prizren.

- **Sipas pikës 2** të kërkesës, Njësia gjatë punës në terren, në Gjykatën Themelore në Prizren, ka gjetur 22 lëndë penale ku i pandehur ka qenë Dibran Hoxha, ndërsa 1 lëndë penale në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Lëndët e inspektuara në Gjykatën Themelore në Prizren:

1. P.nr. 296/06
2. P.nr. 74/09
3. P.nr. 623/09
4. P.nr. 381/11
5. P.nr. 214/12
6. P.nr. 231/12
7. P.nr. 1429/12
8. P.nr. 1949/12
9. P.nr. 1995/12
10. P.nr. 430/13
11. P.nr.1314/13
12. P.nr. 1120/15
13. P.nr. 1631/15
14. P.nr. 485/16
15. P.nr. 650/16
16. P.nr. 1893/16
17. P.nr. 2357/16
18. P.nr. 1140/18
19. P.nr. 32/19
20. P.nr.1253/19²
21. P.nr. 1326/19
22. P.nr. 1167/20
23. P.nr. 1324/12 - kjo lëndë është në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe Njësia e ka pranuar nga administratori i Gjykatës.

² Kjo lëndë pas kundërshtimit është në shqyrtim e sipër.

- **Sipas pikës 3 të kërkesës,** Njësia ka kërkuar nga administratori i Gjykatës Themelore në Prizren informacionet lidhur me ekzekutimin e të gjitha lëndëve për të cilat i pandehuri Dibran Hoxha është gjykuar me gjobë. Sipas informacionit të pranuar nga administratorja e gjykatës 14 (katërmbëdhjetë) lëndë janë ekzekutuar, 2 (dy) lëndë janë pezulluar për shkak të amnistisë dhe 1 (një) lëndë pas ushtrimit të kundërshtimit është në proces të gjyqimit. Lënda P.1253/19.³
- **Sipas pikës 4 të kërkesës,** Njësia nga takimi i zhvilluar me Kryetaren e Gjykatës themelore në Prizren është njoftuar se, në proces gjyqësor e papërfunduar është edhe lënda P.nr.1128/22 (2022:221370). Kjo lëndë i është dhënë në punë gjyqtarit Lulzim Hoxha, dhe nuk është inspektuar.

Në SMIL është identifikuar edhe një lëndë në proces, e papërfunduar me numër P.nr.538/19, e cila është verifikuar po ashtu edhe në gjykatë se është në proces.

Sa i përket informacionit mbi pretendimin nëse janë zhdukur prova të cilat kanë qenë duke u ruajtur në gjykatë, Njësia ka pyetur Kryetaren e Gjykatës dhe e njëjta ka deklaruar se: nuk ka njohuri për humbjen e ndonjë prove.

Sa i përket kohëzgjatjes së dosjeve të lëndëve të përfunduara, Njësia ka paraqitur tabelën e të gjitha lëndëve të inspektuara me të dhëna përkatëse për kohëzgjatjen e procedurës nga data e kryerjes së veprës deri në marrjen e aktgjyqimit në shkallë të parë, përfshirë këtu edhe llojin e veprës penale dhe llojin e dënimit të shqiptuar, si në vijim:

Nr. Rend.	Nr. i lëndës	Data e kryerjes	Data e aktit akuzues	Data e aktgjyqimit	Vepra penale	Lloji i dënimit të shqiptuar
1.	P.nr. 296/06	22.12.2005	3.3.2006	4.5.2007	155 par. 1&23 KPPK ⁴	Dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 muajve (afati i verifikimit 1 vit)
2.	P.nr. 74/09	2.3.2009	23.3.2009	26.6.2009	328 par.2 KPPK	Dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) Euro
3.	P.nr. 623/09	29.3.2009	23.3.2009	22.8.2012	153 par.2 KPPK	Dënim me kusht në kohëzgjatje prej 3 muajve (afati i verifikimit 1 vit).

³ Në këtë lëndë ishte shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 200 euro. Pas ushtrimit të kundërshtimit lënda është në proces e sipër.

⁴ Kodi i përkohshëm Penal

4.	P.nr. 381/11	12.11.2010	22.3.2011	14.11.2022	153 par.2 &1 KPPK	Hedhje e akuzës dhe pushim i procedurës për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit absolut
5.	P.nr. 214/12	3.7.2012	16.7.2012	1.10.2012	328 par.2 KPPK	Dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) Euro
6.	P.nr. 231/12	24.8.2012	6.9.2012	30.10.2012	328 par.2 KPPK	Dënim me gjobë në shumë prej 850 (tetëqind e pesëdhjetë) Euro
7.	P.nr. 1429/12	27.5.2011	15.10.2012	26.4.2013	153 par.2 &1 KPPK	Dënim me gjobë në shumë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) Euro
8.	P.nr. 1949/12	25.1.2012	11.12.2012	22.5.2015	252 par.1 KPPK	Dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro
9.	P.nr. 1995/12	28.11.2011	9.10.2012	3.6.2014	260 PAR.1&23 KPPK	Dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro
10.	PKR.nr. 430/13	22.10.2012	24.12.2013	9.9.2014	260 par.1& 23; 291 par.1 KPPK dhe 375 i KPRK ⁵	<ol style="list-style-type: none"> 1. Për v.p nga neni 260 dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) Euro 2. Për v.p. nga neni 291 refuzohet akuza për shkak se Prokurori ka heqë dorë nga akuza dhe 3. Për v.p. nga neni 375 Dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 muajve (afati i verifikimit 2 vjet)
11.	P.nr.1314/13	11.8.2013	2.9.2013	3.9.2014	410 par.2 &1 KPRK	Refuzohet akuza për shkak se Prokurori ka heqë dorë nga akuza
12.	P.nr. 1120/15	31.3.2012 dhe 4.1.2014	26.5.2015	19.1.2018	188 par.2 &1 nën par.1.4 &31 KPRK	Hedhje e akuzës dhe pushim i procedurës për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit absolut
13.	P.nr. 1631/15	19.8.2015	21.9.2015	11.12.2015	2 vepra nga neni 188 par.1 nën par. 1.4&31 KPRK	Dënim unik me burgim 3 (tre) muaj, i zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 1600 (njëmijë e gjashtëqind) Euro.

⁵ Kodi Penal I Republikës së Kosovës

14.	P.nr. 485/16	14.12.2015	4.3.2016	21.5.2018	188 par.1&2 KPRK	Dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro
15.	P.nr. 650/16	12.8.2012 dhe 1.1.2013-31.12.2013	29.3.2016	4.10.2018	188 par.2 &1 nën par.1.4 KPRK 313 par.1 KPRK	<ol style="list-style-type: none"> 1. Për v.p nga neni 188 Hedhje e akuzës dhe pushim i rprocedurës për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit absolut 2. Për v.p nga neni 313 dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) Euro dhe dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 muajve, (afati i verifikimit 1 vit).
16.	P.nr. 1893/16	5.9.2015	6.9.2016	13.6.2018	185 par.1&31 KPRK	Dënim me gjobë në shumë prej 140 (njëqind e dyzet) Euro
17.	P.nr. 2357/16	4.5.2012	27.12.2012	18.12.2018	155 par.1 KPRK	Hedhje e akuzës për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit absolut
18.	P.nr. 1140/18	2011-2014	23.7.2018	15.2.2019	313 par.2&1 KPRK	Dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) Euro dhe dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve (afati i verifikimit 2 vjet).
19.	PKR.nr. 32/19	6.3.2019	26.4.2019	18.11.2020	189 par.2&1, nën par.1.2 KPRK	Dënim me burgim 6 (gjashtë) muaj, i zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 6000 (gjashtë mijë) Euro. Pas llogaritjes së paraburgimit ka mbetur shuma prej 2340 (dymijë e treqind e dyzet) Euro.
20.	P.nr. 1253/19	21.7.2019	20.9.2019	29.11.2019	184 par/1 KPRK	Dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro. Është duke u zhvilluar procedura pas ushtrimit të kundërshtimit.
21.	P.nr. 1326/19	13.9.2019	4.10.2019	29.10.2019	185 par.1 nën par.4&31 KPRK	Dënim me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) Euro
22.	P.nr. 1167/20	30.10.2020	14.12.2020	12.10.2021	406 KPRK	Dënim me gjobë në shumë prej 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) Euro
23.	P.nr. 1324/12	16.5.2012	27.9.2012	20.6.2013	272 par.1 KPPK	Dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro

Në vijim janë të dhënat kryesore për secilën lëndë të inspektuar veç e veç:

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
1.	Nr. i lëndës	P.nr.296/06
	Data e kryerjes së veprës	22.12.2005
	Akti akuzues dhe data	3.3.2006
	Lloji i veprës penale	155 par.1 lidhur me 23 të KPPK-së, (kushdo që merr pjesë në rrahje, e cila rezulton me vdekje ose lëndime veçanërisht të rënda trupore të një ose më shumë personave, për pjesëmarrje në rrahje dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit).
	Aktgjykimi data	4.5.2007
	Gjyqtari i çështjes	Genc Nixha -Kryetar i trupit gjykues
	Dispozitivi	Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale të parapara me nenin 396. par.3 të KPPPK-së ⁶ ,
	Lloji i dënimit	Dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 muajve (afati i verifikimit 1 vit)
	Të gjetura të veçanta	Në aktgjykim janë marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.
	Ankesë	Nuk ka

⁶ Neni 233 i KPPK-së, parasheh emrin dhe mbiemrin i tij dhe nofkën nëse ka; emrin dhe mbiemrin e prindërve të tij; mbiemrin e vajzërisë së nënës; vendlindjen dhe vendbanimin e tij; ditën, muajin dhe vitin e lindjes; numrin e tij personal të identifikimit; kombësinë dhe shtetësinë; profesionin e tij dhe rrethanat familjare; a di shkrim e lexim; shkollimin e tij; a ka të ardhura personale edhe pozitën e tij financiare; a është ndonjë procedurë penale kundër tij për ndonjë vepër tjetër penale në zbatim e sipër).

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
	Nr. i lëndës	P.nr.74/09
	Data e kryerjes së veprës	2.3.2009
	Akti akuzues dhe data	23.3.2009
2.	Lloji i veprës penale	<p>328 par 1 i KPPK-së, “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve“ (Kushdo që përdor apo vringëllon armët me frikësim, kërcënim ose në ndonjë mënyrë tjetër të paautorizuar apo urdhëron personin tjetër të veprojë në mënyrë të njëjtë dënohet me gjobë deri në 10,000 euro ose me burgim prej një deri në dhjetë vjet). Gjatë shqyrtimit kryesor Prokurori ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale, ashtu që të pandehurin e ka ngarkuar me veprën penale nga neni 328 par. 2. (Kushdo që mban në pronësi, kontrollon, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë, dënohet me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet).</p>
	Aktgjykimi data	26.6.2009
	Gjyqtari i çështjes	Valdete Daka
	Dispozitivi	<p>Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale të parapara me nenin 396 par.3 të KPPK-së. Në të është e shkruar se i pandehuri është i gjendjes së varfër ekonomike dhe "më parë i pa dënuar".</p>
	Lloji I dënimit	“Dënim me gjobë në shumë prej 1,000 (një mijë) Euro. I është konfiskuar edhe arma e zjarrit “mitraloz” dhe 6 fishekë
	Të gjetura të veçanta	Në aktgjykim nuk janë cekur rrethanat lehtësuese apo rënduese konkrete në bazë të të cilave është shqiptuar dënimi.
	Ankesë	Nuk ka ankesë

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
3.	Nr. i lëndës	P.nr.623/09
	Data e kryerjes së veprës	29.03.2009
	Akti akuzues dhe data	Propozim akuzë 24.6.2009
	Lloji i veprës penale	Nga neni 153 par 2 lidhur me par 1 i KPPK-së, “Lëndim i lehtë trupor”. <i>(Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim trupor: (Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer me armë, me ndonjë mjet të rrezikshëm, me ndonjë send tjetër të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryerësi dënohet me burgim deri në tre vjet).</i>
	Aktgjykimi data	22.08.2012
	Gjyqtari i çështjes	Sefedin Bajraktari
	Dispozitivi	Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale të parapara me nenin 396 par.3 të KPPK-së. Në të është e shkruar se i pandehuri “është i gjendjes së varfër ekonomike “
	Lloji i dënimit	Dënim me kusht në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, me (afat verifikimi prej 1 viti).
	Të gjetura të veçanta	Në aktgjykim janë cekur vetëm rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit. (nuk shënon se më herët ka qenë i dënuar). Ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datën 23.3.2015. Gjatë periudhës kohore derisa ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm, i pandehuri ka kryer këto vepra tjera penale sipas këtyre nr. të lëndëve: <ol style="list-style-type: none"> 1. Data e kryerjes 24.8.2012, nr. i lëndës P.nr. 231/12 2. Data e kryerjes, 22.10.2012, nr. i lëndës PKR.nr. 430/13⁷ 3. Data e kryerjes 11.8.2013, nr. i lëndës P.nr. 1314/13 4. Data e kryerjes 4.1.2014, nr. i lëndës P.nr. 112015 5. Data e kryerjes 1.1.2013-31.12.2013, nr. i lëndës P.nr. 650/16 Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, gjatë periudhës së verifikimit i pandehuri ka kryer këto vepra penale: <ol style="list-style-type: none"> 1. Data e kryerjes 19.8.2015, nr. i lëndës P.nr. 1631/15 2. Data e kryerjes 14.12.2015, nr. i lëndës P.nr. 485/16 3. Data e kryerjes 5.9.2015, nr. i lëndës P.nr. 1893/16
	Ankesë	Nuk ka ankesë

⁷ Shënime më të detajuara për këtë lëndë janë në tabelën përkatëse të Lëndës nr. PKR. 430/13

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
4.	Nr. i lëndës	P.nr. 381/11
	Data e kryerjes së veprës	12.11.2010
	Akti akuzues dhe data	Propozim akuzë 22.3.2011
	Lloji i veprës penale	Nga neni 153 par. 2 KPPK- së. “Lëndim i lehtë trupor” (Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim trupor: (Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer me armë, me ndonjë mjet të rrezikshëm, me ndonjë send tjetër të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryerësi dënohet me burgim deri në tre vjet).
	Aktgjykimi data	Aktvendim 14.11.2022
	Gjyqtari i çështjes	Luan Berisha
	Dispozitivi	Hedhet akuza e prokurorisë dhe PUSHOHET procedura penale për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes
	Lloji I dënimit	
	Të gjetura të veçanta	Janë mbajtur 5 shqyrtimet gjyqësore me këto data: 4.9.2013, 11.9.2013, 17.10.2013, 6.11.2013, 22.11.2013 Për këtë lëndë janë marrë 2 aktvendime për hedhje të akuzës dhe pushim të procedurës, për shkak të arritjes së parashkrimit absolut. Njëri aktvendim ka datën e marrjes 14.11.2022, ndërsa tjetri ka datën e marrjes 27.12.2022.
Ankesë	Nuk ka	

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
5.	Nr. i lëndës	P.nr.214/12
	Data e kryerjes së veprës	3.7.2012
	Akti akuzues dhe data	16.7.2012
	Lloji i veprës penale	328 par.2 të KPPK-së, (Kushdo që mban në pronësi, kontrollo, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë, dënohet me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet)
	Aktgjykimi data	1.10.2012
	Gjyqtari i çështjes	Ajser Skenderi - Kryetare e trupit gjykues
	Dispozitivi	Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale të parapara me nenin 396. par.3 të KPPPK-së
	Lloji i dënimit	Dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) Euro.
	Të gjetura të veçanta	Gjatë matjes së dënimit, i janë marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese. <i>Si rrethanë lehtësuese është shënuar se, “është hera e parë që bie në konflikt me ligjin”.</i>
	Ankesë	Nuk ka

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
6.	Nr. i lëndës	P.nr. 231/12
	Data e kryerjes së veprës	24.8.2012
	Akti akuzues dhe data	6.9.2012
	Lloji i veprës penale	328 par.2 të KPPK-së, (Kushdo që mban në pronësi, kontrollo, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë, dënohet me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet)
	Aktgjykimi data	30.10.2012
	Gjyqtari i çështjes	Vaton Durguti Kryetar i Trupit gjykues
	Dispozitivi	Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale të parapara me nenin 396. par.3 të KPPPK-së
	Lloji i dënimit	Dënim me gjobë në shumë prej 850 (tetëqind e pesëdhjetë) Euro dhe konfiskimi i armës
	Të gjetura të veçanta	<i>Në dispozitiv është e shënuar se i pandehuri është i gjendjes së dobët ekonomike. Në arsyetim gjatë matjes së dënimit nuk janë gjetur rrethana rënduese, ndërsa ndër rrethanat lehtësuese është marrë gjendja e tij e mirë ekonomike.</i>
	Ankesë	Nuk ka

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
7.	Nr. i lëndës	P.nr.1429/12
	Data e kryerjes së veprës	27.5.2011
	Akti akuzues dhe data	17.10.2012 Propozim akuzë Kërkesë për dhënien e Urdhrit ndëshkimor
	Lloji i veprës penale	153 par.2 lidhur me par. 1 të KPPK-së, - Lëndimi i lehtë trupor (Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer me armë, me ndonjë mjet të rrezikshëm, me ndonjë send tjetër të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryerësi dënohet me burgim deri në 3 vjet)
	Aktgjykimi data	26.4.2013-Pranohet urdhri ndëshkimor
	Gjyqtari i çështjes	Luan Berisha
	Dispozitivi	Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale,
	Lloji i dënimit	Dënim me gjobë në shumë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) Euro.
	Të gjetura të veçanta	
	Ankesë	Nuk ka

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
8.	Nr. i lëndës	P.nr.1949/12
	Data e kryerjes së veprës	25.1.2012
	Akti akuzues dhe data	11.12.2012 Propozim akuzë
	Lloji i veprës penale	252 par. 1 Vjedhje (Kushdo që tjetrit ia merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet)
	Aktgjykimi data	22.5.2015
	Gjyqtari i çështjes	Teuta Krusha
	Dispozitivi	Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale,
	Lloji i dënimit	Dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro
	Të gjetura të veçanta	Gjatë matjes së dënimit janë marrë parasysh vetëm rrethanat lehtësuese dhe nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese.
	Ankesë	Nuk ka

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
9.	Nr. i lëndës	P.nr. 1995/12
	Data e kryerjes së veprës	28.11.2011
	Akti akuzues dhe data	9.10.2012
	Lloji i veprës penale	260 par.1 lidhur me 23 të KPPK-së, - Dëmtimi i pasurisë së luajtshme (kushdo që e dëmton, e asgjëson apo e bën të pa përdorshme pasurinë e luajtshme të personit tjetër dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj).
	Aktgjykimi data	3.6.2014
	Gjyqtari i çështjes	Zejnullah Gashi
	Dispozitivi	Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale
	Lloji i dënimit	Dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro
	Të gjetura të veçanta	<i>Aktgjykimi në hyrje datën e marrjes e ka 3.6.2014, ndërsa në fund e ka datën 9.10.2012. Nuk përmenden të dhënat penale të të pandehurit. Në aktakuzë gjendja materiale është e përshkruar si e mesme, ndërsa në aktgjykim si e dobët.</i>
	Ankesë	Prokuroria
	Vendimi i Gj. së Apelit	Refuzim dhe vërtetim i aktgjykimit P.nr. 1995/12

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
10.	Nr. i lëndës	PKR.nr. 430/13
	Data e kryerjes së veprës	22.10.2012
	Akti akuzues dhe data	Aktakuzë 24.12.2013
	Lloji i veprës penale	<p>1. 260 par 1 lidhur me par 23 të KPPK-së- dëmtimi i pasurisë së luajtshme (Kushdo që e dëmton, e asgjëson apo e bën të papërdorshme pasurinë e luajtshme të personit tjetër dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj).</p> <p>2. 291 par 1 i KPPK-së- shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni (Kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit, helmët ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë energji tjetër të çfarëdo lloji shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo për pasurinë e një rëndësie thelbore dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.)</p> <p>3. 375 par 1 i KP-së- përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga (Kushdo që përdorë armë apo materie plasëse në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.)</p>
	Aktgjykimi data	Aktgjykim me pranim fajësie 9.9.2014
	Gjyqtari i çështjes	Trupi gjykues në përbërje të : Xhevdet Elshani-
	Dispozitivi	Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale
	Lloji I dënimit	<p>1. Për veprën penale sipas nenit 260 par 1, dënim me gjobë prej 300 (treqind) euro</p> <p>2. Për veprën penale sipas nenit 375 par 1, dënim me kusht prej 6 muajve (afati i verifikimi 2 vite)</p> <p>Dënimi plotësues – marrja e pistoletës së tipit Cërvena Zastava e kalibrit 7.65 mm.</p> <p>3. Për veprën penale nga neni 291 par 1, është refuzuar akuza për shkak se prokurori ka heqë dorë nga akuza.</p>
	Të gjetura të veçanta	<p>Gjatë matjes së dënimit janë shënuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e shqiptimit të dënimit.</p> <p>Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, gjatë periudhës së verifikimit i pandehuri ka kryer këto vepra penale:</p> <p>1.Data e kryerjes 19.8.2015, nr. i lëndës P.nr. 1631/15</p> <p>2. Data e kryerjes 14.12.2015, nr. i lëndës P.nr. 485/16</p> <p>3. Data e kryerjes 5.9.2015, nr. i lëndës P.nr. 1893/16⁸</p>
	Ankesë	Nuk ka

⁸ Këto vepra penale janë të përfshira edhe në lëndën P.nr.623/09

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
11.	Nr. i lëndës	P.nr. 1314/13
	Data e kryerjes së veprës	11.8.2013
	Akti akuzues dhe data	Aktakuzë 2.9.2013
	Lloji i veprës penale	<p>410 par 2 lidhur me par 1 të KP-së-Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni</p> <p>(1. Kushdo që sulmon ose kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar, gjyqtarin, prokurorin apo personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare lidhur me sigurinë e përgjithshme, sigurinë e Republikës së Kosovës apo ruajtjen e rendit publik, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.</p> <p>2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të personit zyrtar apo ndihmësi të tij ose përfshin kanosje për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.</p>
	Aktgjykimi data	3.9.2014
	Gjyqtari i çështjes	Luan Berisha
	Dispozitivi	Refuzohet akuza për shkak se prokuroria tërhiqet nga akuza
	Lloji i dënimit	
	Të gjetura të veçanta	
	Ankesë	Nuk ka

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
12.	Nr. i lëndës	P.nr. 1120/15
	Data e kryerjes së veprës	31.3. 2012 dhe 4.1.2014
	Akti akuzues dhe data	26.5.2015
	Lloji i veprës penale	188 par.2 lidhur me par.1 nën par. 1.4 lidhur me 31 të KPRK –Lëndim i lehtë trupor, (Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim deri në 3 vjet) dhe 188 par.1 nën par. 1.4 lidhur me 31 të KPRK (dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 vit.)
	Aktvendim data	19.1.2018
	Gjyqtari i çështjes	Teuta Krusha
	Dispozitivi	Hedhet akuza dhe pushohet procedura për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes penale
	Lloji i dënimit	
	Të gjetura të veçanta	Janë mbajtur këto seanca: 1. 15.7.2015 2. 25.9.2015 3. 8.6.2017
	Ankesë	Nuk ka

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
13.	Nr. i lëndës	P.nr.1631/15
	Data e kryerjes së veprës	19.8.2015
	Akti akuzues dhe data	21.9.2015
	Lloji i veprës penale	2 vepra penale nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me 31 të KPRK 1. Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në: 1.4. dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
	Aktgjykimi data	11.12.2015- Aktgjykim me prnaim të fajësisë
	Gjyqtari i çështjes	Sadije Selmani
	Dispozitivi	Pjesërisht i përmban të dhënat personale,
	Lloji i dënimit	Dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 3 muajve, i zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 1600 (një mijë e gjashtëqind) Euro.
	Të gjetura të veçanta	
	Ankesë	Prokuroria
Vendimi i Gj. së Apelit	Refuzim dhe vërtetim i aktgjykimit P.nr. 1631/2015	

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
14.	Nr. i lëndës	P.nr.485/2016
	Data e kryerjes së veprës	14.12.2015
	Akti akuzues dhe data	Aktakuzë 4.3.2016
	Lloji i veprës penale	<p>188 par 1 lidhur me par 2, të KP-së - Lëndim i lehtë trupor. Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në:</p> <p>1.1. dëmtimin e përkohshëm ose dobësimin e një organi apo pjese të trupit të personit tjetër;</p> <p>1.2. zvogëlimin e përkohshëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar;</p> <p>1.3. shëmtimin e përkohshëm të personit tjetër; ose</p> <p>1.4. dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.</p> <p>2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.</p>
	Aktgjykimi data	Aktgjykim me pranim të fajësisë 21.5.2018
	Gjyqtari i çështjes	Teuta Krusha
	Dispozitivi	Pjesërisht i përmban të dhënat personale,
	Lloji I dënimit	200 euro gjobë
	Të gjetura të veçanta	<p>Gjatë matjes së dënimit Gjykata në pajtim nenin 7,41,43,46,73 dhe nenit 188 par 1 lidhur me par 2 të KPK, i shqipton dënimin nën kufirin e paraparë me ligj e aplikoi - nenin 75 par 1 nën par 1.2 e 1.3 dhe nenit 76 par 1 nën par 1.7 të KPK dhe në kuptim të nenit 635 të KPPK .</p> <p>I bie që ka zbatuar rregullat për zbutjen e dënimit.</p> <p>Në aktgjykim shënohet se, gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa janë shënuar rrethanat lehtësuese .</p>
Ankesë	Nuk ka	

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
15.	Nr. i lëndës	P.nr.650/16
	Data e kryerjes së veprës	12.8.2012/ /1.1.2013-31.12.2013
	Akti akuzues dhe data	29.3.2016
	Lloji i veprës penale	<ol style="list-style-type: none"> 188 par.2 lidhur me par. 1 nën par.1.4 të KPRK –Lëndim i lehtë 313 par.1 të - Shmangia nga tatimi (kushdo që me qëllim që ai apo personi tjetër të fsheh apo t'i shmanget, pjesërisht apo tërësisht, pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, jep të dhëna të pavërteta apo nuk i përfshin të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, pasurinë, gjendjen ekonomike apo fakte të tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 vjet).
	Aktgjykimi data	4.10.2018- Aktgjykim me pranim të fajësisë
	Gjyqtari i çështjes	Fatmir Krasniqi
	Dispozitivi	Pjesërisht i përmban të dhënat personale
	Lloji i dënimit	<ol style="list-style-type: none"> Vepra penale e lëndimit të lehtë ka aritur afatin e parashkrimit absolut të ndjekjes penale Për veprën penale Shmangie nga tatimi, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) Euro dhe dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 muajve, (afati i verifikimit 1 vit).
	Të gjetura të veçanta	<p><i>Gjatë matjes së dënimit gjykata ka aplikuar rregullat për zbutjen e dënimit, (nenet 74, 75 dhe 76) të KPRK.</i></p> <p><i>Aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm me datën 10.12.2018.</i></p> <p><i>Gjatë afatit 1 vjeçar të verifikimit i pandehuri ka kryer këto vepra penale:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Data e kryerjes 6.3.2019, nr. i lëndës P.nr. 32/19</i> <i>21.7.2019, nr. i lëndës 1253/19</i> <i>13.9.2019, nr. i lndës P.nr. 1326/19</i>
	Ankesë	Nuk ka

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
16.	Nr. i lëndës	P.nr.1893/16
	Data e kryerjes së veprës	5.9.2015
	Akti akuzues dhe data	6.9.2016- Kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor
	Lloji i veprës penale	185 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, - Kanosja (Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit te personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj)
	Aktgjykimi data	13.6.2018 Aktgjykim- pranohet urdhri ndëshkimor
	Gjyqtari i çështjes	Shpresa Emra
	Dispozitivi	Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale
	Lloji i dënimit	Dënim me gjobë në shumë prej 140 (njëqind e dyzet) Euro.
	Të gjetura të veçanta	
	Ankesë	Nuk ka

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
17.	Nr. i lëndës	P.nr. 2357/16
	Data e kryerjes së veprës	4.5.2012
	Akti akuzues dhe data	27.12.2012
	Lloji i veprës penale	155 par 1 i KPK-së, Pjesëmarrje në rrahje Kushdo që merr pjesë në rrahje, e cila rezulton me vdekje ose lëndime veçanërisht të rënda trupore të një ose më shumë personave, për pjesëmarrje në rrahje <i>dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.</i>
	Aktgjykimi data	Aktvendim i dt. 18.12.2018, Hudhet aktakuza dhe PUSHOHET procedura
	Gjyqtari i çështjes	Shpresa Emra
	Dispozitivi	Hedhet akuza dhe pushohet procedura për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes penale
	Lloji i dënimit	
	Të gjetura të veçanta	<p>Kjo lëndë është kthyer në rigjykim në Departamentin e Krimeve të rënda. Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.nr. 421/15 të dt. 24.12.2015 pjesërisht e ka vërtetuar aktgjykimin, ndërsa për të akuzuarit Dibran Hoxha dhe Avdyl Krasniqi është kthyer në rigjykim,</p> <p>Nga ky departament lënda është deleguar në kompetencë në Departamentin e përgjithshëm me datën 6.12.2016.</p> <p>Sipas aktvendimit për parashkrim, vepra penale pretendohet se është kryer më dt. 4.5.2012 (dhe se për këtë vepër penale afati i parashkrimit relativ është 2 vite dhe se afati i parashkrimit absolut i ndjekjes është 4 vite) do të thotë se parashkrimi ka arritur më dt. 4.5.2016)</p> <p>Lënda nga departamenti i krimeve të rënda ka kaluar në departamentin e përgjithshëm si e parashkruar.</p>
	Ankesë	Nuk ka ankesë

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
	Nr. i lëndës	P.nr.1140/18
	Data e kryerjes së veprës	2011-2014
	Akti akuzues dhe data	23.7.2018
18.	Lloji i veprës penale	<p>313 par.2 lidhur me par. 1 të - Shmangia nga tatimi</p> <p>1. Kushdo që me qëllim që ai apo personi tjetër të fsheh apo t'i shmanget, pjesërisht apo tërësisht, pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, jep të dhëna të pavërteta apo nuk i përfshin të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, pasurinë, gjendjen ekonomike apo fakte të tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.</p> <p>2. Kur detyrimi nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon shumë prej pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.</p>
	Aktgjykimi data	15.2.2019- Aktgjykim me pranim të fajësisë
	Gjyqtari i çështjes	Fidan Hoxha
	Dispozitivi	Pjesërisht i përmban të dhënat personale
	Lloji i dënimit	Dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) Euro dhe dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 muajve (afati i verifikimit prej 2 vitesh)
	Të gjetura të veçanta	<p><i>Aprovim i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë në mes tij dhe Prokurorit.</i></p> <p><i>Gjatë matjes së dënimit nuk kanë gjetur rrethana të veçanta rënduese.</i></p> <p>Ky aktgjykim është bërë i plotëfuqishëm më dt. 25.3.2019.</p> <p>Pas shqiptimit të dënimit me kusht i panderuri ka kryer vepra të tjera penale, gjatë afatit të verifikimit. Veprat e kryera evitohen sipas këtyre numrave:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Data e kryerjes, 6.3.2019, nr. i lëndës P.nr. 32/19, 2. Data e kryerjes 13.9.2019, nr, i lëndës P.nr. 1326/19; 3. Data e kryerjes 21.7.2019, nr. i lëndës P.nr. 1253/19, dhe 4. Data e kryerjes 30.10.2020, nr. i lëndës P.nr. 1167/20 <p><i>Në shkresat e lëndës nuk është gjetur ndonjë vendim për revokim të dënimit me kusht.</i></p>
	Ankesë	Nuk ka

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
19.	Nr. i lëndës	PKR.nr.32/19
	Data e kryerjes së veprës	6.3.2019
	Akti akuzues dhe data	26.4.2019
	Lloji i veprës penale	189 par. 5 lidhur me par.1 pika 1.2 të KPRK-së, - lëndim i rëndë- Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni është kryer me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim jo më pak se tre (3) vjet.
	Aktgjykimi data	18.11.2020
	Gjyqtari i çështjes	Ajser Skenderi Kryetare e trupit dhe Xheladin Osmani e Kymete Kicaj anëtarë
	Dispozitivi	Pjesërisht i përmban të dhënat personale, mungon shënimi për dënimet e mëparshme
	Lloji i dënimit	Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve, i zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 6000 (gjashtë mijë) Euro, (i ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe si dënim me gjobë i ka mbetur shuma prej 2340 (dy mijë e treqind e dyzet) Euro.
Të gjetura të veçanta	<p>Akuza në fillim ka qenë për veprën penale nga neni 178 lidhur me 28 i KPRK-së, (vrasje e mbetur në tentativë), por në seancën e fundit gjyqësore Prokurori e ka ricilësuar në veprën penale lëndim i rëndë.</p> <p><i>Gjykata e ka gjykuar me veprën penale lëndim i rëndë nga neni 186 par. 3 nën par. 3.1 i KPRK-së, si ligj më i favorshëm. Për këtë vepër dënimi i paraparë është burgim prej 1 deri në tetë 8 vjet.</i></p> <p><i>Gjatë matjes së dënimit gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese. Në pjesën para gjykimit ka aplikuar rregullat për zbutjen e dënimit, (nenet 70, 71 dhe 72) të KPRK, Nr. 06/L-074)</i></p> <p><i>Në shkresat e lëndës janë dy kërkesa të të pandehurit për kthim të pasaportës, të datave 17.7.2019 dhe 11.11.2019, me arsyetim se do të udhëtojë me familje në Dubai.</i></p> <p><i>Në aktgjykim në të dhënat personale është shënimi se i pandehuri është i gjendjes së varfër ekonomike.</i></p>	
Ankesë	Prokuroria	
	Vendimi i Gj. së Apelit	Refuzim dhe vërtetim i aktgjykimit PKR.nr. 32/19 Të gjetura të veçanta <i>Në arsyetimin e aktgjykimin e gjykatës së Apelit shkruan se Gjykata Themelore i ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese në mesin e të cilave është “ se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin”. Mirëpo kjo rrethanë nuk është e shkruar në Aktgjykimin e atakuar.</i>

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
20.	Nr. i lëndës	P.nr.1253/19
	Data e kryerjes së veprës	21.7.2019
	Akti akuzues dhe data	20.9.2019- Aktakuzë- Kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor
	Lloji i veprës penale	184 par 1 i KPRK Sulm, (Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit).
	Aktgjykimi data	29.11.2019- pranohet urdhëri ndëshkimor
	Gjyqtari i çështjes	Luan Berisha
	Dispozitivi	Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale
	Lloji i dënimit	Dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro gjobë
	Të gjetura të veçanta	
	Ankesë/kundërshtim	Ka kundërshtim dhe lënda është në proces e sipër.

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
21.	Nr. i lëndës	P.nr. 1326/19
	Data e kryerjes së veprës	13.9.2019
	Akti akuzues dhe data	4.10.2019- Aktakuzë
	Lloji i veprës penale	<p>185 par 1 nën par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së . Bashkëkryerje, vepra penale lëndim i lehtë trupor nga neni</p> <p>1. Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në:</p> <p>1.4. dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet.</p>
	Aktgjykimi data	29.10.2019 - me pranim fajësie
	Gjyqtari i çështjes	Teuta Krusha
	Dispozitivi	Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale
	Lloji i dënimit	Dënim me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) Euro
	Të gjetura të veçanta	<p>Në aktakuzë shkruan se i pandehuri është i gjendjes së mesme ekonomike. Në procesverbalin e datës 9.10.2019, gjatë marrjes së shënimeve të të pandehurit është bërë përmirësimi i kësaj të dhëne nga i gjendjes së mesme në gjendje të “varfër”ekonomike.</p> <p>Gjatë matjes së dënimit janë theksuar vetëm rrethanat lehtësuese.</p>
	Ankesë	<p>Ka ankesë nga mbrojtësi i të pandehurit për, shkak të vendimit mbi dënimin.</p> <p>Përgjigje ka paraqitur edhe prokurori i shtetit, i cili ka propozuar që të refuzohet ankesa.</p>
Aktgjykimi i Gj. Apelit	Refuzim ankese si e pa bazuar.	

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Prizren	
22.	Nr. i lëndës	P.nr.1167/20
	Data e kryerjes së veprës	30.10.2020
	Akti akuzues dhe data	14.12.2020- Aktakuzë me Propozim për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor
	Lloji i veprës penale	406 i KPRK-së heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare spo shenjave nga neni. (Kushdo që heq ose dëmton vulën zyrtare apo shenjën e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të objektit ose të lokaleve, apo kushdo që hap objektet e siguruara ose hyn në lokalet e tilla pa e hequr ose pa e dëmtuar vulën apo shenjën, ose hap sendin në të cilin ka qenë e vendosur vula apo shenja e tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet).
	Aktgjykimi data	12.10.2021– pranohet urdhri ndëshkimor
	Gjyqtari i çështjes	Refki Piraj
	Dispozitivi	Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale
	Lloji i dënimit	160 (njëqind e gjashtëdhjetë) euro gjobë
	Të gjetura të veçanta	
	Ankesë	Nuk ka kundërshtim

Lënda e inspektuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj

Nr. Rendor.	Gjykata Themelore Ferizaj	
23.	Nr. i lëndës	P.nr.1324/12
	Data e kryerjes së veprës	16.5.2012
	Akti akuzues dhe data	27.9.2012 Propozim akuzë
	Lloji i veprës penale	Në propozim akuzë fillimisht vepra ka qenë e cilësuar nga 252 par. 1 i KPPK-së - Vjedhja (Kushdo që tjetrit ia merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet). Gjatë shqyrtimit gjyqësor Prokurori ka bërë ri-cilësimin e veprës në “Pranim i mallrave të vjedhura”nga neni 272 par. 1 të KPRK-së.
	Aktgjykimi data	20.6.2013
	Gjyqtari i çështjes	Hysnije Gashi
	Dispozitivi	Nuk i përfshin të gjitha të dhënat personale
	Lloji i dënimit	Dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro.
	Të gjetura të veçanta	I pandehuri e ka pranuar fajësinë. Gjatë matjes së dënimit Gjykata nuk ka gjetur rrethana rënduese.
	Ankesë	Nuk ka

Të gjetura tjera

Në Gjykatën Themelore në Prizren kanë qenë 22 lëndë në të cilat kanë qenë të përfshira 26 vepra penale, ndërsa në Gjykatën Themelore në Ferizaj ka qenë 1 lëndë me 1 vepër penale.

Në vijim janë shënimet për kryerjen e këtyre veprave penale sipas kohës së kryerjes së tyre.

Nr. rendor	Sipas viteve									
	2005	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2019	2020
1.	1	2	1	2	10	2	2	3	3	1
Gjithsej	27 vepra penale									

I pandehuri Dibran Hoxha është akuzuar për këto 27 vepra penale, ndërsa është gjykuar për 20 prej tyre.

Për 20 vepra penale janë të shqiptuara këto lloje të dënimeve:

1. Për 15 vepra penale janë shqiptuar 15 dënime me gjobë⁹;
 2. Për 2 vepra penale janë shqiptuar 2 dënime me kusht;
 3. Për 3 vepra penale janë shqiptuar 3 dënime me gjobë dhe me kusht.
- Për 2 vepra penale është refuzuar akuza për shkak të heqjes dorë të Prokurorit nga ndjekja penale
 - Për 5 vepra penale është hedhur akuza dhe ka pushuar procedura penale për shkak të arritjes së afatit absolut të ndjekjes penale

Njësia po ashtu ka analizuar edhe gjendjen ekonomike të të pandehurit të paraqitur si në aktin akuzues të prokurorisë ashtu edhe në dispozitivin e aktgjykimeve të marrura nga gjykata.

⁹ Një gjobë e cila është llogaritur këtu është në proces për shkak se është ushtruar kundërshtim.

Në vijim është paraqitur tabela me shënimet përkatëse:

Nr. rend.	Nr. i lëndës	Gjendja ekonomike e të pandehurit						Vërejtje
		Akti akuzues			Aktgjykimi			
		E mirë	E mesme	E dobët	E mirë	E mesme	E Dobët	
1.	P.nr. 296/06		X			X		
2.	P.nr. 74/09			X			X	
3.	P.nr. 623/09			X			X	
4.	P.nr. 381/11	-	-	-	-	-	-	mungon
5.	P.nr. 214/12			X			X	
6.	P.nr. 231/12			X			X	
7.	P.nr. 1429/12		X			X		
8.	P.nr. 1949/12		X			X		
9.	P.nr. 1995/12		X				X	
10.	PKR.nr. 430/13			X			X	
11.	P.nr.1314/13			X		X		
12.	P.nr. 1120/15	X			-	-	-	mungon
13.	P.nr. 1631/15			X		X		
14.	P.nr. 485/16			X			X	
15.	P.nr. 650/16	-	-	-			X	
16.	P.nr. 1893/16	X			-	-	-	mungon
17.	P.nr. 2357/16	-	-	-	-	-	-	mungon
18.	P.nr. 1140/18		X			X		
19.	PKR.nr. 32/19		X				X	
20.	P.nr.1253/19		X			X		
21.	P.nr. 1326/19		X				X	
22.	P.nr. 1167/20		X			X		
22.	P.nr. 1324/12		X		-	-	-	mungon
Gjithsej		2	10	8	0	8	10	

Në 2 akte akuzuese, gjendja ekonomike e të pandehurit është vlerësuar si “ e mirë”, ndërsa në 10 si “”e mesme”” dhe në 8 akte akuzuese si “”e dobët””.

Në anën tjetër në asnjë aktgjykim gjendja ekonomike e të pandehurit nuk është vlerësuar si “e mirë”, në 8 aktgjykime gjendja ekonomike e të pandehurit është vlerësuar si “e mesme” dhe në 10 aktgjykime gjendja ekonomike e të pandehurit është vlerësuar si e “dobët”. Pavarësisht këtij vlerësimi të gjendjes ekonomike të të pandehurit i njëjti është gjykuar me

dënim me gjobë për 15 (pesëmbëdhjetë) vepra penale ndërsa për 3 (tri) vepra penale është gjykuar edhe me dënim me gjobë edhe me dënim me kusht.

Përkitazi me gjyqtarët që i kanë gjykuar lëndët penale ndaj të pandehurit Dibran Hoxha, Njësia ka nxjerrë tabelën si në vijim:

Nr. rend.	Nr. i lëndës	Gjyqtari/ja	
1.	P.nr. 296/06	Genc Nixha	Gj. Themelore Prizren
2.	P.nr. 74/09	Valdete Daka	Gj. Themelore Prizren
3.	P.nr. 623/09	Sefedin Bajraktari	Gj. Themelore Prizren
4.	P.nr. 381/11	Luan Berisha	Gj. Themelore Prizren
5.	P.nr. 214/12	Ajser Skenderi	Gj. Themelore Prizren
6.	P.nr. 231/12	Vaton Durguti	Gj. Themelore Prizren
7.	P.nr. 1429/12	Luan Berisha	Gj. Themelore Prizren
8.	P.nr. 1949/12	Teuta Krusha	Gj. Themelore Prizren
9.	P.nr. 1995/12	Zejnullah Gashi	Gj. Themelore Prizren
10.	PKR.nr. 430/13	Xhevdet Elshani	Gj. Themelore Prizren
11.	P.nr.1314/13	Luan Berisha	Gj. Themelore Prizren
12.	P.nr. 1120/15	Teuta Krusha	Gj. Themelore Prizren
13.	P.nr. 1631/15	Sadije Selmani	Gj. Themelore Prizren
14.	P.nr. 485/16	Teuta Krusha	Gj. Themelore Prizren
15.	P.nr. 650/16	Fatnir Krasniqi	Gj. Themelore Prizren
16.	P.nr. 1893/16	Shpresa Emra	Gj. Themelore Prizren
17.	P.nr. 2357/16	Shpresa Emra	Gj. Themelore Prizren
18.	P.nr. 1140/18	Fidan Hoxha	Gj. Themelore Prizren
19.	PKR.nr. 32/19	Ajser Skenderi	Gj. Themelore Prizren
20.	P.nr. 1253/19	Luan Berisha	Gj. Themelore Prizren
21.	P.nr. 1326/19	Teuta Krusha	Gj. Themelore Prizren
22.	P.nr. 1167/20	Refki Piraj	Gj. Themelore Prizren
23.	P.nr. 1324/12	Hysnije Gashi	Gj. Themelore Ferizaj

Analizë ligjore :

Gjatë inspektimit të këtyre lëndëve për kualifikime të veprave penale janë zbatuar :

1. Kodi i Përkohshëm Penal (UNMIK/Rreg/2003/25) dhe
2. Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. Nr. 04/L-082
3. Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 06/L-074

Për zhvillimin e procedurës penale janë zbatuar:

1. Kodi i përkohshëm i procedurës penale UNMIK/Rreg/2003/26
2. Kodi i procedurës penale Nr. 04/L-123

Kodi i përkohshëm i procedurës penale (UNMIK/Rreg/2003/26)

1. Neni 396 i këtij Kodi rregullon përpilimin e aktgjykimit. Në par. 3 të këtij neni, taksativisht është paraparë se çka duhet të përfshijë dispozitivi i aktgjykimit. Këtë dispozitë shprehimisht e lidh me nenin 233, paragrafi 1 i këtij Kodi, i cili shpjegon se çka nënkuptohet me të dhëna personale të të pandehurit.

Neni 233, parasheh që gjatë marrjes në pyetje për herë të parë i pandehuri duhet të tregojë emrin dhe mbiemrin e tij dhe nofken nëse ka; emrin dhe mbiemrin e prindërve të tij; mbiemrin e vajzërisë së nënës; vendlindjen dhe vendbanimin e tij; ditën, muajin dhe vitin e lindjes; numrin e tij personal të identifikimit; kombësinë dhe shtetësinë; profesionin e tij dhe rrethanat familjare; a di shkrim e lexim; shkollimin e tij; a ka të ardhura personale edhe pozitën e tij financiar; **a është ndonjë procedurë penale kundër tij për ndonjë vepër tjetër penale në zbatim e sipër;** dhe nëse është i mitur, identitetin e përfaqësuesit të tij ligjor. Ai informohet për detyrimin e tij për të njoftuar për çdo ndryshim adrese ose për çdo qëllim ndryshimi të vendqëndrimit.

Gjatë inspektimit është gjetur se aktgjykimet të cilat janë marr bazuar në KPPP nuk janë përfshirë të gjitha të dhënat siç është përcaktuar në nenin 396 par 3, veçanërisht ka munguar numri personal i identifikimit dhe se a është ndonjë procedurë penale kundër tij për ndonjë vepër tjetër në zbatim e sipër.

Bazuar në nenin 305 par 1 pika 1 i po këtij Kodi edhe Aktakuza përmban emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhënat e tij personale (neni 233 i këtij Kodi);

Gjatë inspektimit është gjetur se në aktet akuzues nuk janë të përfshira të gjitha të dhënat personale të të pandehurit, ashtu siç parashihet me nenin 305 par. 1, të KPPP-së. Edhe këtu veçanërisht ka munguar numri personal i identifikimit dhe se a është ndonjë procedurë penale kundër tij për ndonjë vepër tjetër në zbatim e sipër.

2. Neni 354 par 2 thotë se: Të dhënat mbi dënimet e mëparshme dhe dënimet e vuajtura nga i akuzuari nuk janë pjesë e shkresave penale dhe lexohen pas prezentimit të provave (fjalja e fundit e nenit 375 e këtij Kodi).

Neni 375 i po këtij Kodi thotë: Të dhënat nga evidenca e të dënuarve si dhe të dhënat tjera për dënimet për vepra penale mund të lexohen pas përfundimit të procedurës së provave. Kur i akuzuari pranon fajësinë, të gjitha informatat lidhur me dënimet e mëparshme të të akuzuarit lexohen para se palët të paraqesin fjalën përfundimtare

Gjatë inspektimit është gjetur se në lëndët të cilat janë zhvilluar me Kodin e përkohshëm të procedurës penale, në procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore nuk janë gjetur të dhënat e kërkuara sipas nenit 354 par 2 dhe nenit 375.

Kodi i procedurës penale Nr. 04/L-123

3. Neni 370 i këtij Kodi, rregullon përmbajtjen dhe formën e aktgjykimit. Në paragrafin 3, theksohet se "Dispozitivi i aktgjykimit përfshin të **dhënat personale të të akuzuarit** dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për vepër penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuza për atë vepër apo me të cilin refuzohet aktakuza". Se çka përfshijnë të dhënat personale kuptohet nga neni 154, i cili rregullon " Marrjen në pyetje të të pandehurit gjatë deklaratës në procedurë paraprake. Paragrafi 1 i këtij neni thekson se:

1. Gjatë marrjes në pyetje për herë të parë, i pandehuri duhet të tregojë emrin dhe mbiemrin e tij dhe nofken nëse ka; emrin dhe mbiemrin e prindërve të tij; mbiemrin e vajzërisë së nënës; vendlindjen dhe vendbanimin e tij; ditën, muajin dhe vitin e lindjes; numrin e tij personal të identifikimit; kombësinë dhe shtetësinë; profesionin e tij dhe rrethanat familjare; a di shkrim e lexim; shkollimin e tij; a ka të ardhura personale edhe pozitën e tij materiale; **a është ndonjë procedurë penale kundër tij për ndonjë vepër tjetër penale në zbatim e sipër**; dhe nëse është i mitur, identitetin e përfaqësuesit të tij ligjor. Ai informohet për detyrimin e tij për të njoftuar për çdo ndryshim adrese ose për çdo qëllim ndryshimi të vendqëndrimit.

*Gjatë inspektimit është gjetur se në aktgjykimet të cilat janë marrë bazuar në KPP-në, në të dhënat personale të të akuzuarit nuk janë përfshirë të gjitha të dhënat e përcaktuara sipas nenit 154, ku ka munguar e dhëna personale se **a është ndonjë procedurë penale kundër tij për ndonjë vepër tjetër penale në zbatim e sipër**;*

Bazuar në nenin 241 par 1 pika 1.2 të po të këtij Kodi, Aktakuza përmban emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhënat e tij personale.

Gjatë inspektimit është gjetur se edhe në aktet akuzuese, në të dhënat personale të të akuzuarit nuk janë përfshirë të gjitha të dhënat e përcaktuara sipas nenit 154, me mungesë të shënimeve për të dhënat personale se **a është ndonjë procedurë penale kundër tij për ndonjë vepër tjetër penale në zbatim e sipër**.

Edhe pse dispozita e nenit 370 par 1 nuk e përcakton saktë lidhjen me nenin 154 (për dallim me atë që KPPP e përcakton me nenin 396 par 3 dhe e lidhë me nenin 233) konsiderohet se, të dhënat e përcaktuara në nenin 154 duhet të jenë pjesë e dispozitivit të aktgjykimit.

4. Neni 349 përcakton të dhënat penale të të akuzuarit ku theksohet se: Të dhënat penale nga evidenca e të dënuarve, si dhe të dhënat tjera për dënimet për vepra penale mund të lexohen pas përfundimit të procedurës së provave. Kur i akuzuari pranon fajësinë, të gjitha informatat lidhur me dënimet e mëparshme të të akuzuarit lexohen para se palët të paraqesin fjalën përfundimtare.

Gjatë inspektimit është gjetur se lëndët të cilat janë zhvilluar me këtë Kod, në procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore (ato të cilat i kemi pasur në dispozicion) nuk janë gjetur të dhënat e kërkuara sipas nenit 349.

5. Gjatë matjes së dënimit në asnjë aktgjykim nuk është shënuar si rrethanë rënduese se, i pandehuri ka qenë më parë i dënuar apo është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj tij.

6. Në 3 lëndë (P.nr. 485/16, P.nr.650/16 dhe P.nr.32/19) janë zbatuar dispozitat e Kodit Penal për zbutjen e dënimit nën minimumin e dënimit të paraparë për veprën për të cilën është gjykuar.

Në asnjërin nga këto aktgjykime si rrethanë rënduese nuk janë paraqitur dënimet e mëparshme të të pandehurit siç e përcakton neni 70 par 2 pika 2.13 KPPK Nr. 06/074 dhe neni 74 par 2 pika 2.13 i KPRK Nr. 04/L-082-së.

7. Ekzekutimi i dënimeve alternative-Dënimit me kusht

Rregullorja e UNMIK-2004/46 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale

Neni 153 par 1 i kësaj rregulloreje thekson se, kur gjykata shqipton dënimin me kusht, ajo i`a dërgon aktgjykimin me të gjitha të dhënat që i posedon shërbimit sprovues për ekzekutimin e këtij dënimi alternativ.

Neni 154 par 3 thekson se, shërbimi sprovues i raporton gjykatës për përfundimin e suksesshëm të periudhës së verifikimit. Pas pranimit të raportit të tillë, gjykata merr vendim me të cilin vërtetohet mbajtja e dënimit alternativ.

Ligji Nr. 03/L-191 PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE

Neni 150 par 1 thekson se, kur gjykata shqipton dënimin me kusht, ajo i`a dërgon aktgjykimin me të gjitha të dhënat që i posedon shërbimit sprovues për ekzekutimin e këtij dënimi alternativ.

Neni 151 par 3 thekson se, Shërbimi sprovues i raporton gjykatës për përfundimin e suksesshëm të periudhës së verifikimit. Pas pranimit të raportit të tillë, gjykata merr vendim me të cilin vërtetohet mbajtja e dënimit alternativ.

Ligji NR. 04/L-149 PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE

Neni 143 par 1 thekson se, kur gjykata shqipton dënimin me kusht, ajo i`a dërgon aktgjykimin me të gjitha të dhënat që i posedon shërbimit sprovues për ekzekutimin e këtij dënimi alternativ.

Neni 144 par 1 thekson se, kur gjykata shqipton dënimin me kusht dhe urdhëron përmbushjen e ndonjë obligimi sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, shërbimi sprovues mbikëqyr përmbushjen e obligimit, ndërsa paragrafi 2 thekson se, Nëse personi i dënuar nuk e përmbush obligimin e urdhëruar nga gjykata, sipas paragrafit 1. të këtij neni Shërbimi sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mos përmbushjen e obligimeve .

Siç shihet nga baza ligjore e paraqitur më lart, gjatë periudhës së kryerjes së veprave penale nga i pandehuri kanë qenë në fuqi një rregullore dhe dy ligje, ku në të gjitha këto është përcaktuar se, gjykata duhet t`ia përcjell Shërbimit Sporovues aktgjykimin me të cilin shqiptohet dënimi me kusht.

NJIGJ, gjatë inspektimit ka gjetur se 3 (tri) lëndë kanë pasur të shqiptuar dënim me gjobë dhe kusht ndërsa 2 (dy) lëndë kanë pasur të shqiptuar dënimin me kusht.

Në shkresa të lëndës nuk janë gjetur fletëdorëzimet me të cilat konstatohet se, aktgjykimet (të cilat kanë të shqiptuar dënime me kusht) i janë dorëzuar Shërbimit Sprovues. Sipas njoftimit të pranuar nga administratorja e Gjykatës Themelore në Prizren e cila edhe një herë ka verifikuar se, a janë në shkresa të lëndës fletëdorëzimet për dorëzimin e aktgjykimeve Shërbimit Sprovues figuron se, në asnjërën nga lëndët përkatëse nuk janë këto fletëdorëzime.

Konkluzion i përgjithshëm:

Njësia për Inspektim Gjyqësor, përveq të gjeturave dhe cekurave si më lartë (në raport) konsideron se, Gjykatat lëndët e të cilave janë inspektuar duhet të aplikojnë dispozitat ligjore me të cilat përcaktohet përmbajtja e dispozitivit të aktgjykimit, leximit dhe paraqitjes së të dhënave penale të të pandehurit gjatë procedurës penale si dhe ekzekutimit të dënimit me kusht.